



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

---

V E N D I M

Nr.2479, datë 10. 04. 2014

Për

**“Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr.13, datë 16.04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, dhe publikimin e mendimeve dhe komenteve të paleve te interesuara mbi këshillimin publik te realizuar për këtë dokument”.**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- |                |            |         |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro     | Xhixho     | Kryetar |
| 2. Z. Alban    | Karapici   | Anëtar  |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar  |
| 4. Z. Benon    | Paloka     | Anëtar  |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe      | Anëtar  |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 10.04. 2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, dhe publikimin e mendimeve dhe komenteve të paleve te interesuara mbi këshillimin publik te realizuar për këtë dokument”.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Kodi i Procedurës Administrative (**KPrA**);
2. Shkronja p) e nenit 8, nenet 87, 88 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
3. Rregullore Nr.13, datë 16.04.2010 per “ Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010 (Rregullore), e ndryshuar;

4. Vendimi Nr. 2419, datë 06.02.2014 per "Miratimin e Dokumentit për këshillim publik "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore Nr.13, datë 16.04.2010, "Për Portabilitetin e Numrit", e ndryshuar".

### **KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shpresor si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi Projektaktin
  - Dokumenti "Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 "Për Portabilitetin e Numrit" miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar, dhe mendimet e komentet e operatoreve""
  - Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- si dhe,  
Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N :**

1. Dokumentacioni "Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 "Për Portabilitetin e Numrit" miratuar me VKD nr. 1219, datë 07.04.2010, e ndryshuar, dhe mendimet e komentet e operatoreve i pergatitur nga Grupi i punës sipas Urdhërit Nr. 1098, datë 28. 01. 2014, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
2. Ndërhyrja në Rregullore i shërben qëllimit të përmirësimit të kuadrit rregullator për ofrimin e shërbimit të Portabilitetit të Numrit dhe eliminimit të problemeve të evidentuara si:
  - kërkesat për bartje nga pajtimtarë me detyrime të pashlyera kundrejt operatorit dhënës;
  - vendosja e një kohë minimale te detyrueshme për kërkuesin e bartjes që të qëndrojë në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje;
  - refuzimi i kërkesave për bartje duke shfrytëzuar dhe keqinterpretuar përmbajtjen e nenit 15 etj
3. Operatorët në komentet dhe mendimet e dhëna në këshillimin publik në përgjithësi janë shprehur dakort me propozimet e AKEP.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë:

1. Kodi i Procedurës Administrative (*KPrA*);
2. Neni 7, neni 8, neni 110, dhe neni 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 " Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

3. Urdhër i Kryetarit Nr. 1098, datë 28. 01. 2014.

## V E N D O S :

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit” miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara mbi këshillimin publik të realizuar për këtë dokument sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**

## DOKUMENTI

### Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010”, e ndryshuar.

1. Neni 5, Të drejtat dhe detyrimet e operatorit dhënës, pika 5 të Rregullores Nr. 13, date 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar me përmbajtje:

*“ Operatori dhënës është i detyruar te eksportoje numrin edhe kur kontrata është anuluar, por anulimi do të hyjë në efekt në të ardhmen (p.sh. për shkak të kohëzgjatjes minimale të kontratës), për sa kohë që numri mund të përdoret për të pranuar thirrje hyrëse. Nëse një numër është çaktivizuar vetëm përkohësisht (p.sh. sipas sanksioneve të kontratës për mos pagesë), operatori dhënës është përsëri i detyruar të eksportoje numrin”*

Ndryshon dhe bëhet:

*“Operatori dhënës është i detyruar të kryejë bartjen e numrit edhe kur shërbimet e kontraktuara me pajtimtarin janë pezulluar ose ndërprerë në mënyrë të njëanshme përpara konsiderimit të përfunduar të kontratës sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren Nr. 31, datë 26.12.2013 “Për Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike” (Seksioni VIII: Vazhdimi dhe Ndërprerja e Shërbimeve).*

*Në rastet kur për shkak të mos pagesës së faturës mujore pajtimtari gjendet në kushtet e ndërprerjes së njëanshme të shërbimeve të kontraktuara, operatori dhënës është i detyruar të pranojë kërkesën për bartje por bartja do të përfundohet vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimin e pagesës së faturuar”.*

2. Neni 4, pika 5, Të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit, te Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07.04. 2010, e ndryshuar, me përmbajtje:

*“Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit dhënës mund të parashikojë që pajtimtari duhet të paguajë kompensim për përfitime të caktuara nga kontrata, siç janë uljet ose telefonat e subvencionuar, nëse pajtimtari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të kontratës. Kohëzgjatja minimale e kontratës dhe shuma e kompensimit duhet të përcaktohet në kontratë.”*

Ndryshon dhe bëhet:

*“Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit dhënës mund të parashikojë që pajtimtari duhet të paguajë kompensim për përfitime të caktuara nga kontrata, siç janë uljet ose telefonat e subvencionuar, nëse pajtimtari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të kontratës. Kohëzgjatja minimale e kontratës dhe shuma e kompensimit duhet të përcaktohet në kontratë. **Koha minimale e detyrueshme për kërkuesin e bartjes që të qëndrojë në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje është 3 muaj.”***

3. Neni 15, Përgjigja për bartje pika 2), gërma c) paragrafi aa) të Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar, me përmbajtje:

*“- kërkesa për bartje nuk mund të lexohej ose ka ndonjë gabim tjetër lidhur me specifikimet teknike të kërkesës për bartje;”*

Ndryshon dhe bëhet:

*“Kërkesa për bartje pranohet por nuk mund të përfundohet sepse ky numër rezulton me detyrime te papaguara”.*

Bashkëlidhur është Shtojca formularë “Kërkesë për bartjen e numrave” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010 dhe ndryshuar me Vendimin nr.1530 datë 18.03. 2011.



Deklaroj si më poshtë:

1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës, kam njoftuar ndryshimin e të dhënave të mia të regjistruara tek baza e të dhënave të këtij operatori (nëse ka patur ndryshime të tilla), dhe dëshiroj të anuloj kontratën me operatorin dhënës për këto numra' numer.
2. Dëshiroj të nënshkruaj kontratë me operatorin marrës sipas kushteve kontraktore, kushteve dhe tarifave të përgjithshme të biznesit të cilat më janë paraqitur nga operatori marrës në dokumente të veçanta.
3. Dëshiroj që të dy operatorët të bashkëpunojnë dhe të bartin numrin e përmendur nga rrjeti i operatorit dhënës në rrjetin e operatorit marrës në kohën e kërkuar. Autorizoj operatorin marrës, që në emrin tim, të ri-drejtojë kërkesën time operatorit dhënës për anulimin e kontratës time ekzistuese për numrin e përmendur.

---

(Vendi dhe data)

---

(Nënshkrimi)

## Perfundimet e Keshillimit Publik

Per:

**“Disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010**

**“Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar””**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ne zbatim te Vendimit **Nr.2419, datë 06.02.2014**, te Keshillit Drejtues, ka nisur proceduren e keshillimit publik per **“ Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar””**.

Ne perfundim te afatit prej 30 ditesh te percaktuar ne vendimin e mesiperme te KD, rezulton se ne adrese te AKEP kane ardhur komente dhe mendime ne lidhje me **“ Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”** nga palet e interesuara.

Te interesuarit ju kane dhene pergjigje pyetjeve te adresuara ne dokumentin e keshillimit publik si dhe kane bere komente e kane dhene opinione ne lidhje me kete dokument.

Keto komente paraqiten ne vijim te ketij dokumenti, respektivisht :

- 1. AKEP** propozon që Neni 5, Të drejtat dhe detyrimet e operatorit dhënës, pika 5 të Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar, “ Operatori dhënës është i detyruar te eksportojë numrin edhe kur kontrata është anuluar, por anulimi do të hyjë në efekt në të ardhmen (p.sh. për shkak të kohëzgjatjes minimale të kontratës), për sa kohë që numri mund të përdoret për të pranuar thirrje hyrëse. Nëse një numër është çaktivizuar vetëm përkohësisht (p.sh. sipas sanksioneve të kontratës për mos pagesë), operatori dhënës është përsëri i detyruar të eksportojë numrin”

Të dryshojë dhe të bëhet:

“Operatori dhënës është i detyruar te eksportojë numrin edhe kur kontrata është anuluar, por anulimi do të hyjë në efekt në të ardhmen (p.sh. për shkak të kohëzgjatjes minimale të kontratës), për sa kohë që numri mund të përdoret për të pranuar thirrje hyrëse. Në rastet kur pajtimtari ka detyrime të pashlyera sipas përcaktimeve në dokumentin “Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike””, miratuar me VKD nr. 2405, datë 26.12.2013, atëhere operatori dhënës është i detyruar të pranojë kërkesën për bartje por bartja do të ekzekutohet vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimet.”



## **Komentet e operatoreve:**

### **Operatori A:**

Ne lidhje me propozimin mbi pranimin e kërkeses për bartje në rastin kur pajtimtari është debitor por bartja do të ekzekutohet vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimet, jemi dakort me qëllimin që ka shtyre AKEP për ndryshimin e kësaj pike, por mendojmë se propozimi i AKEP nuk është shumë i qartë. Jemi të mendimit që nuk është përcaktuar çfare kuptohet me "ekzekutim" dhe si do të ndodhë konkretisht. Gjithashtu, mendojmë se ky parashikim bie nëndesh me pikën 2 të nenit 12 të Rregullores, meqenëse kjo pikë parashikon se procesi i plotë duhet të realizohet brenda 3 ditësh. Rrjedhimisht, propozojmë që ky paragraf të rishikohet në kuadër edhe të pikës 1, neni 12 të Rregullores.

### **Operatori B:**

Operatori B mbështet qëndrimin e AKEP për pezullimin e bartjes për ata pajtimtarë që kanë detyrime të pashlyera në rrjetin e operatorit dhënë. Sidoqoftë nevojiten disa sqarime dhe përcaktime të mëtejshme për të shmangur hapësirat për abuzivizëm në dinamikën ndërvepruese mes operatorëve përgjatë procesit. Sikurse jemi shprehur edhe në letrën tonë të datës 06.09.2013, Operatori B, në mënyrë të ngjashme me operatorët e tjerë celularë, përballet me rrezikun e debitorëve të këqinj që kërkojnë të portojnë numrat e tyre nga një operator në tjetrin, duke lënë pas borxhe, për të cilat procesi i mbledhjes me procedura gjyqësore është i vështirë dhe i ngadalshëm.

Në anën tjetër, përfshirja e detyrimeve të pashlyera si arsye për refuzimin e portabilitetit mbart riskun potencial që të dis-ekuilibrojë procesin e portabilitetit, në dëm të pajtimtarëve apo operatorëve të përfshirë në proces.

Përcaktimi i detyrimeve të pashlyera të një pajtimtari kërkon kohë të konsiderueshme, p.sh. në rast se ka pasur trafik në roaming, apo në varësi të mënyrës së pagesës, dhe operatorët dhënë mund të abuzojnë me këtë arsye pezullimi, për të zgjatur/vonuar procesin e portabilitetit, në mënyrë që të përdorin strategji të rifitimit të klientit (win-back strategies). Madje pajtimtari mund të cilësohet si debitor edhe në rastin kur pagesa është kryer nëpërmjet bankës, por transferata e pagesës nuk ka përfunduar ende në llogarinë e operatorit.

Përsa më lart, Operatori B sugjeron që përveç ndryshimit të propozuar nga AKEP në nenin 5, pika 5 të Rregullores 13/2010, të përcaktohen qartazi në Rregullore edhe sa vijon:

Përkufizimi i "detyrimit të prapambetur të pashlyer" nga pajtimtari. Operatori B sugjeron që "Detyrim i prapambetur i pashlyer nga pajtimtari" të konsiderohet detyrimi i pajtimtarit kundrejt operatorit dhënë për shërbimet e ofruara nga Operatori ndaj pajtimtarit në përputhje me Kontratën e Pajtitimit midis tyre, për të cilin është lëshuar një faturë tatimore nga operatorit dhënë, e cila nuk është paguar nga pajtimtari brenda afateve të pagesës të përcaktuara në faturë dhe/ose në Kontratën e Pajtitimit;

Vërtetimi i shlyerjes së detyrimit. Operatori B kupton se vërtetimi i shlyerjes së detyrimit të prapambetur përbën një proces kompleks që ka nevojë për qartësi dhe mbi të gjitha bashkëpunim korrekt dhe të shpejtë ndërmjet operatorëve të përfshirë në proces. Për rrjedhojë operatori B sugjeron zbatimin e një prej metodave të mëposhtme:

Të shtohet në “Kërkesën për Bartje” një seksion ku pajtimtari të vetëdeklarojë se nuk ka detyrime të pashlyera tek Operatori Dhënës. Ky konfirmim nga pajtimtari duhet të jetë i domosdoshëm për vlefshmërinë e “Kërkesës për Bartje” dhe nisjen e “Kërkesës për bartje” tek Operatori dhënës nga Operatori marrës. Në rast të mos-ekzekutimit të Kërkesës për bartje për detyrim të pashlyer të prapambetur, barra e provës duhet t’i kalojë Operatorit dhënës i cili brenda 3 orësh nga marrja e Kërkesës për bartje duhet t’i konfirmojë dhe sqarojë/provojë Operatorit marrës dhe pajtimtarit ekzistencën e detyrimeve të pashlyera të prapambetura. Në rast se Operatori dhënës nuk konfirmon dhe sqaron brenda 3 orësh nga marrja e Kërkesës për bartje, provat e ekzistencës së detyrimeve të pashlyera të prapambetura të pajtimtarit që ka kërkuar bartjen, atëherë arsyeja e pezullimit do të konsiderohet e pavlefshme dhe procesi i bartjes duhet të vazhdojë normalisht nga Operatori dhënës.

Krijimi i një baze të dhënash të mbajtur nga Operatorët celularë për të përfshirë të gjithë pajtimtarët që kanë detyrime të pashlyera të prapambetura në momentin e ngritjes së kërkesës për bartje. Operatori B sugjeron që kjo bazë të dhënash, sipas eksperiencës më të mirë të vendeve evropiane, të krijohet dhe administrohet nga një Shoqatë e Operatorëve të Komunikimeve Elektronike, pa ndërhyrjen e AKEP dhe të autorizohet nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pajtimtarët duhet të informohen rregullisht për ekzistencën e kësaj baze të dhënash dhe për funksionimin e saj në dispozitat e Kontratës së Pajtitimit. Qëllimi i mbajtjes së kësaj baze të dhënash të përbashkët duhet të parashikohet qartë në dokumentin e nënshkruar nga të gjithë operatorët për krijimin dhe funksionimin e bazës së të dhënave të përbashkët për debitorët, dhe të dhënat nuk duhet të përdoren për asnjë qëllim tjetër apo të aksesohen nga palë të paautorizuara. Kostot e mirëmbajtjes dhe administrimit të bazës së të dhënave duhet të ndahen në mënyrë të barabartë nga operatorët që do të marrin pjesë në Shoqatë dhe që do të kenë akses në bazën e të dhënave. Operatori B gjykon që në rast dakordësie për ngritjen e kësaj databaze, nevojitet një konsultim i veçantë publik për ndërtimin, kompetencat, funksionimin, dhe mirëmbajtjen e saj.

Të parashikohet në Rregulloren e portabilitetit si arsye për Refuzimin e procesit të portimit nga Operatori dhënës nëse pagesa e detyrimeve të pashlyera të prapambetura të konfirmuara nuk likujdohet nga pajtimtari brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për bartje nga Operatori dhënës dhe konfirmimit të detyrimit;

Të parashikohet në Rregulloren e Portabilitetit si arsye për Refuzimin e procesit të portimit nga Operatori dhënës nëse përpara kërkesës për bartje janë marrë masa ndaj pajtimtarit për ndërprerjen/bllokimin e përkohshëm të pjesshëm/plotë në rrjet, në përputhje me Kontratën e Pajtitimit, për shkak të detyrimeve të pashlyera. Barra e provës duhet t’i kalojë operatorit dhënës i cili brenda 3 orësh nga marrja e kërkesës për bartje duhet t’i konfirmojë dhe sqarojë operatorit marrës detajet mbi bllokimin/ndërprerjen.

Të përcaktohen detajet teknike në lidhje me procesin, duke filluar që nga verifikimi i detyrimeve të prapambetura të pashlyera të pajtimtarit, pezullimin e kërkesave për bartje në sistemin CRDB të portabilitetit në rastin e pezullimit të kërkesave për bartje për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve të pajtimtarit, e deri në ekzekutimin e tyre pas shlyerjes së detyrimeve nga pajtimtari, apo refuzimin për mosshlyerje të detyrimit brenda 30 ditësh nga pranimi i Kërkesës për bartje.

Të përcaktohet detyrimi i Operatorit dhënës dhe marrës që të ekzekutojnë kërkesën për bartje menjëherë pasi të konfirmohet nga pajtimtari shlyerja e detyrimit në një nga format e njohura me ligj;

Sa më sipër, Operatori B sugjeron që të përfshihen dispozitat e mëposhtme në Nenin 15, paragrafi 2, c) gg), hh) dhe paragrafi 2/1:

“gg) pajtimtarit i është aplikuar ndërprerje e përkohshme e pjesshme/plotë e aksesit në rrjet dhe ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për shkak të detyrimeve të pashlyera të prapambetura nga operatori dhënës, siç përcaktohet në Kontratën e Pajtitimit.

hh) pajtimtari nuk ka shlyer pagesën e detyrimeve të prapambetura brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për bartje.

2/1 Në rastet e pezullimit të kërkesës për bartje sipas nenit 5.5 ose të refuzimit të kërkesës për bartje sipas nenit 5.4, 15.2,c) gg) dhe 15.2,c) hh) të kësaj Rregulloreje, arsyeja e pezullimit do të konsiderohet e pavlefshme dhe procesi i bartjes do të vazhdojë normalisht me ekzekutimin e kërkesës për bartje nga Operatori dhënës, në rastin kur provat mbi ekzistencën e detyrimeve dhe/ose bllokimin/ndërprerjen nuk i paraqiten Operatorit marrës dhe Pajtimtarit, nga Operatori dhënës (me iniciativën e tij) brenda 3 orësh nga marrja e “Kërkesës për bartje”. Operatorët do të emërojnë një person kontakti, i cili do të ketë një numër telefoni dhe një adresë email-i ku Operatori dhënës do të dërgojë provat si më lartpërmendur.”

Gjithashtu, në mënyrë që të akomodohen sugjerimet e mësipërme në Rregulloren për Portabilitetin dhe për arsye përputhshmërie në tekst, propozojmë që të kryhen edhe ndryshime të tjera të domosdoshme në Rregulloren 13/2010 si më poshtë vijon:

Në Nenin 2, duhen përfshirë Përkufizimet e mëposhtme:

“Ndërprerje/bllokim” është masa e ndërprerjes së përkohshme të pjesshme/plotë të aksesit në rrjet dhe ofrimit të shërbimeve të komunikimit elektronik, e marrë nga Operatori në përputhje me Kontratën e Pajtitimit, për shkak të mospërbushjes nga pajtimtari të detyrimeve të pagesës sipas afateve të përcaktuara nga operatori në faturë dhe /ose në Kontratën e Pajtitimit”.

“Detyrim i pashlyer i prapambetur nga pajtimtari” është detyrimi i pajtimtarit kundrejt operatorit dhënës për shërbimet e ofruara në përputhje me Kontratën e Pajtitimit, për të cilat është lëshuar një faturë tatimore nga operatori dhënës, e cila nuk është paguar nga pajtimtari brenda afateve të pagesës të përcaktuara në faturë dhe/ose në Kontratën e Pajtitimit;

Në Nenin 4, pas paragrafit 2, duhet të përfshihet paragrafi i mëposhtëm:

“2/1. Pajtimtari ka të drejtë të bartë numrat kundrejt të cilëve Operatori Dhënës nuk ka marrë asnjë masë ndërprerje/bllokimi të përkohshëm të pjesshëm/plotë, për shkak të detyrimeve të pashlyera nga pajtimtari, dhe për të cilët pajtimtari i ka paguar detyrimet e pashlyera të prapambetura brenda afatit kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për bartje nga Operatori dhënës.”

Në Nenin 5, pas paragrafit 4, duhet të përfshihet paragrafi i mëposhtëm:

“Operatori Dhënës nuk do të eksportojë një numër në rast se atij i është ndërprerë/bllokuar në mënyrë të përkohshme aksesit në rrjet, për shkak të masave të marra nga operatori për detyrime të pashlyera nga pajtimtari.”

Neni 5, paragrafi 5 duhet të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Operatori dhënës është i detyruar të eksportojë numrin edhe kur kontrata është përfunduar, por përfundimi do të hyjë në fuqi në të ardhmen (për shembull për shkak të kohëzgjatjes minimale të kontratës), për sa kohë që numri mund të përdoret për të kryer dhe për të marrë thirrje.

Në rastet kur pajtimtari ka detyrime të pashlyera të prapambetura atëherë Operatori dhënës është i detyruar të pranojë kërkesën për bartje, por bartja do të ekzekutohet vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimet.

Në rastin e pezullimit të Kërkesës për bartje për arsye të detyrimeve të pashlyera të prapambetura, Operatori dhënës ka detyrimin që (me iniciativën e tij) t’i konfirmojë dhe sqarojë Operatorit marrës dhe pajtimtarit brenda 3 orësh nga marrja e Kërkesës për bartje, provat e ekzistencës së detyrimeve të pashlyera të prapambetura të pajtimtarit që ka kërkuar bartjen. Arsyeja e pezullimit do të konsiderohet e pavlefshme dhe Operatori dhënës duhet të ekzekutojë kërkesën për bartje në rastin kur ai nuk i paraqet provat brenda afatit prej 3 orësh si më lartpërmendur në këtë pikë.

Detajet teknike në lidhje me procesin përcaktohen në manualin e bazës së të dhënave referencë e centralizuar (CRDB).

Operatorët dhënës dhe marrës do të ekzekutojnë kërkesën për bartje menjëherë pasi të konfirmohet nga pajtimtari shlyerja e detyrimit në një nga format e njohura me ligj, por jo më larg se 30 ditë nga data e pranimit të kërkesës për bartje. Në rast të mos-shlyerjes së detyrimit nga pajtimtari brenda afatit kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për bartje, atëherë Operatori dhënës do të ketë të drejtën që të refuzojë kërkesën për bartje.”

Në nenin 13, të shtohet paragrafi 5 si më poshtë vijon:

“Operatori marrës dhe Operatori dhënës do të vazhdojnë procesin e bartjes, për sa kohë që Operatori dhënës nuk pezullon ekzekutimin për detyrime të pashlyera dhe konfirmon dhe sqaron Operatorin marrës dhe pajtimtarin sipas afatit përcaktuar më sipër.”

(sqarim: Operatori B kujton se kjo dispozitë është e nevojshme në rast se pranohet alternativa 1- mbi vërtetimin e detyrimit të shlyer).

Në nenin 15, paragrafi 1 të shtohen paragrafët c) dhe d) si vijon:

“c) nëse numrit që do të bartet i është aplikuar ndërprerje e përkohshme e pjesëshme/plotë e aksesit në rrjet dhe ofrimin të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për shkak të detyrimeve të pashlyera të prapambetura të pajtimtarit.

d) nëse pajtimtari e ka detyrime të pashlyera të prapambetura.”

### **Operatori C:**

Ne lidhje me rishikimin në Rregullore të qendrimit që duhet mbajtur ndaj kërkesës për bartje nga pajtimtare me detyrime të pashlyera kundrejt operatorit dhënës dhe propozimit të AKEP për ekzekutimin e bartjes vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimet e tij. Operatori C shprehet i shqetësuar se ky ndryshim, do të ndikojë negativisht në efikasitetin e procesit duke i shtuar refuzimet e kërkesave për bartje nga operatorët.

a) Sjellja abuzuese e operatorit dhënës. Duke parë ecurinë e implementimit të këtij procesi muajt e fundit, si edhe mënyrën e bashkëpunimit mes operatorëve, ku sic dihet problematikat ende vazhdojnë, dhe shpesh krijohen refuzime artificiale nga operatorët. Operatori C shprehet se arsyeja direkte e mosfunksionimit të procesit ka të bëjë kryesisht me sjelljen abuzuese të operatorit dhënës.

Operatori C gjykon se ndryshimi i mesiperme do tu krijoje edhe me teper rrundesi operatoreve qe kane abuzuar me kete proces per te mos lejuar largimin e pajtimtareve nga rrjeti i tyre, nderkohe qe problemi i detyrimeve te pashlyera merr zgjidhje nga vendosja e nje kohe minimale te detyrueshme per kerkuesin e bartjes perpara se te vendose nje kerkese tjeter per bartje.

b) Zgjidhja e problemit te detyrimeve te pashlyera nga mekanizma te tjere ligjore.

Operatori C, eshte i vetedijshem se ceshtja e detyrimeve te pashlyera nga pajtimtaret eshte nje nga problemet me kryesore ne marredhenien mes cdo operatori dhe pajtimtarit. Megjithate gjykojme se mekanizmat ligjore dhe organet kompetente te percaktuara ne Kontraten e pajtimit nenshkruar mes paleve, jane mjetet e duhura dhe te mjaftueshme ligjore per ti dhene zgjidhje ketij problemi. Sic u theksua edhe me lart, nese lidhim procesin e portabilitetit te numrit me detyrimet e pashlyera nga pajtimtari, pare sjelljen e deritanishme te operatoreve, do te arrijrne ne bllokim te procesit, kur nga ana tjeter ekzistojne rruge ligjore per zgjidhjen e kesaj problematike.

c) *Mbrojtja e se drejtes se pajtimtarit per portabilitetin e numrit.* Operatori C gjykon se ekzekutimi i bartjes veterne pas shlyerj es se detyrimeve nga pajtimtari, perben shkelje te se drejtes se tij per tu portuar ne rrjetin qe deshiron. Nga ana tjeter, nese pajtimtari me detyrime te pashlyera lejohet te portohet, sic edhe parashikohet ne Kerkesen per bartjen e Numrit, pajtimtari eshte serish edhe pas bartjes, i detyruar ti paguaje operatorit dhenes te gjitha detyrimet e papaguara qe dalin nga kontrata ekzistuese, te cilat mund te perfshijne tarifen per portabilitetin e numrit dhe/ose kompensimin ne rast anulimi te kontrates para kohezgjatjes minimale te kontrates te rene dakord.

d) *Mungesa e percaktimeve te qarta ligjore e teknike ne Rregullore qe te garantojne transparencen e funksionimit te procesit, nese ky propozim miratohet.*

Ndryshimi i mesiperme, aq me teper i pa shoqeruar me zgjidhjet teknike e ligjore, qe do te siguronin se operatori dhenes refuzon vetem pajtimtaret e tij me detyrime te pashlyera, nuk do te zgjidhte qellimin per te cilin AKEP kerkon te nderhyhet. Konkretisht, nese ky ndryshim aprovohet, duhet te saktosohet me percaktimet e qarta ligjore, teknike dhe operacionale ne lidhje me sa me poshte:

*Percaktimin ne rregullore te termit "detyrime te pashlyera", pra kur do te konsiderohet nje pajtimtar me detyrime te pashlyera, pasi ne dokumentin "Rregulla per Termat e Pergjithshme te Kontrates se Pajtimit per Lidhjen dhe Aksesin ne Rrjetin Publik te Komunikimeve Elektronike", miratuar me VKD nr. 2405. date 26.12.2013, nuk jepet ky percaktim. Keshtu pershembull, nuk eshte e mundur qe detyrimet e pashlyera te perfshijne te gjitha detyrimet e pajtimtarit deri ne ditin e dorezimit te kerkeses per bartje, pasi sistemi nuk mund te gjeneroje fatura ne baze kerkese per fature. Faturat gjenerohen vetem per nje periudhe te caktuar dhe nuk mund te dallohet nese nje pajtimtar ka shlyer te gjitha detyrimet e tij deri ditin e dorezimit te kerkeses per bartje. Gjithashtu edhe nese pajtimtari shlyen gjithe detyrimet e tij, mund te shkaktohen vonesa te ndryshme (vonesa ne sistemin bankar ne procesimin e pageses, vonesa operacionale etj), te cilat kthejne ne jo eficiente rrjedhen e procesit per sa i perket afateve ligjore te kthimit te pergjigjeve etj.*

Gjithe sa me lart, i jep mundesi operatorit dhenes per te krijuar artificialisht arsye refuzimi dhe abuzuar lehtesisht me procesin.

Nje problem tjeter lidhet me rrjedhen dhe afatet e procesit te portimit, i cili bazohet ne dy hapa:

(a) Hapi i parashikimit: ku konfirmohet se informacioni eshte korrekt dhe vendoset koha per aktivizimin;

(b) Hapi i aktivizimit: ku aktivizohet/deaktivizohet pajtimtari ne kohen qe eshte percaktuar ne fazen e parashikimit.

Keto dy faza lidhen me njera tjetren nga afate te percaktuara, pra ne fazen e parashikimit merret data dhe ora eaktivizimit nga sistemi. Nese ky sistem nuk kthen pergjigje ne kohen e percaktuar,

aktivizimi nuk mund të realizohet. Thëksoj rne se ky proces bazohet në afate dhe jo kushte të caktuara, pra konkretisht është e pamundur të bazohet në kusht e në lidhje me shlyerjen e detyrimeve.

Në rregullore, gjithashtu duhet të përcaktohen qartësisht, përveç mekanizmave për zgjidhjen e rnosmarreveshjeve sipas legjislacionit në fuqi, *hapat dhe afatet e pershkallesimit të një mosmarreveshje portimi mes operatoreve, koha e nderhyrjes së AKEP për garantimin e zbatimit të Rregullores, masat përkatëse për zgjidhjen efektive të rastit etj* ,

Ky rregullim kërkohet për tu dhënë një zgjidhje të shpejtë dhe efice nte rasteve të shumta të rnosmarreveshjeve mes paleve, ku sic dihet mekanizmat aktuale ligjore, për shkak të afateve të tyre tejet të gjata, nuk u kanë dhënë zgjidhje për disa muaj problematikave në lidhje me procese portimi të numrit.

Bazuar në sa më lart Operatori C kërkon, përjashtimin e detyrimeve të pashlyera të pajtimtarit ndaj operatorit të dhenes, nga e drejta për portimin e numrit, për të mos demtuar ecurinë e procesit të portabilitetit dhe për të mos i dhënë një mundësi me tëper abuzimi operatorit të dhenes.

## **Operatori D :**

Operatori D mbështet propozimin e AKEP në lidhje me ndryshimin e pikës 5 të nenit 5 të Rregullores për Portabilitetin e Numrit, të ndryshuar, për sa i përket ceshtjes në lidhje me pranimin e kërkesës për bartje nga operatorit të dhenes dhe bëjnë të ekzekutueshme të kesaj kërkesë vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimet.

Rastet e refuzimeve të kërkesave për bartje për arsye të detyrimeve të mëparshme të pashlyera nga abonentët postpaid kanë qenë të shpeshta në procesin e portimit të numrave midis operatoreve duke sjelle shumë probleme dhe konflikte midis operatoreve, por dhe midis abonentëve dhe operatoreve përkatës që kanë refuzuar kërkesat e port out. Zgjidhja e këtyre konflikteve shpesh herë ka qenë objekt i ankimeve të shumta administrative nga operatorët tek AKEP dhe zgjidhja e këtyre mosmarreveshjeve ka qenë shumë e vështirë për t'u arritur me mirëkuptimin e paleve duke bllokuar për një kohë të gjatë procesin e portimit dhe situata të tilla kanë demtuar operatorët në zhvillimin normal të aktivitetit të tyre, në lidhje me trajtimin e këtyre borxheve të pashlyera pas ikjes së abonentëve tek operatorit marres.

Vështiresitë e trajtimit të borxheve të keqija të pajtimtareve postpaid kanë përfunduar deri në dyert e Gjykatave me procese të gjata dhe të kushtueshme nga ana financiare për operatorët deri në zgjidhjen përfundimtare të këtyre mosmarreveshjeve.

Një shqetësim i madh është shkalla e lartë e borxheve të keqija sidomos në telefoninë celulare dhe vështiresia në identifikimin e abonentëve të ashtuquajtur "bad debtors", ku janë hasur shpesh raste të abonentëve që brenda një kohe shumë të shkurter kanë portuar numrat e tyre nga një operator tek tjetri dhe duke krijuar në këtë mënyrë detyrime të njëkoheshme me disa operatore njëherësh dhe për pasoje dhe bllokim të procesit të portimit në shumë raste dhe situata konfliktuale midis operatoreve.

Një gjë e tillë demton dhe konkurrencën e drejtë dhe të ndershme duke bërë që disa operatore të abuzojnë nga situata të tilla në kurriz të operatoreve të tjerë, duke shkelur në këtë mënyrë rregulloren për procesin e portimit si dhe duke demtuar kështu konkurrencën midis tyre.

Të tilla problematika janë diskutuar dhe në shumë takime të zhvilluara midis paleve si dhe me AKEP, ku shpesh është trajtuar si zgjidhje e mundshme e këtij problem dhe krijimi i një regjistri

apo database ne lidhje me borxhet e keqija i nevojshem per identifikimin e “bad debtors” ne menyre qe te evitohen situatat e permendura me siper dhe se si duhet vepruar per portimin e numrave te kesaj kategorie abonentesh.

Per keto arsye Operatori D mendon se eshte shume i rendesishem adresimi i kesaj problematike per te shmangur situatat e evidentuara ne lidhje me kete ceshtje, dhe nje menyre e tille eshte dhe propozimi i bere nga AKEP dhe per mos ekzekutimin e nje kerkese per bartje nga ana e operatorit dhenes derisa abonenti qe ka bere kerkesen te kete shlyer detyrim(in)et perkates(e) me kete operator.

Ne vijim te kesaj ceshtje Operatori D sugjeron gjithashtu qe ne bashkepunim me AKEP dhe operatoret e tjere te behet i mundur implementimi i nje regjistri apo databaze per regjistrimin e “bad debtors” per te lehtesuar dhe standartizuar porcesin e portimit ne lidhje me kete kategori te abonenteve dhe dicka e tille te perfshihet ne Rregulloren e Portabilitetit te Numrit.

Kjo situatë e rritjes se borxhit te keq shkakton mjaft problem per financat e shoqerive celulare te cilat reflektohen pervec te tjerave sidomos direkt ne sasine e investimeve qe keto shoqeri do te kene mundesi te bejne me tej per ofrimin e produkteve dhe sherbimeve te reja me teknologjite me bashkekohore

Keshtu Operatori D sic ka parashtuar edhe ne kerkesat e saj te meparshme parashtron propozimet e saj si me poshte:

1. Ndryshimi i rregullores se portabilitetit te numrit:

a. Minimum i qendrimit pas aktivizimit te SIM (prepaid apo postpaid) duhet te jete 6 muaj ne nje operator. (kjo do te eliminonte abuzimin ne hapine pare te regjistrimit te nje abonenti te ri, per te eliminuar rastet kur nje abonent regjistrohët per here te pare dhe fillon nje process portimi le te themi dy jave pas kontrates si dhe per te eliminuar rastet kur mund te jete justifikimi qe po portohet per here te pare)

b. Minimumi i qendrimit ne nje operator pas nje process port in duhet te jete 6 muaj minimum.

c. Nese klienti ka borxhe te papaguara (te pakten fatura e fundit e leshuar dhe data e pageses ka mbaruar, si dhe kohezgjatja inicuese e kontrates ka mbaruar) procesi i port out nuk duhet lejuar. (duhet percaktuar qarte jo vetem ky rast, po kur abonenti pervec se ka nje llogari te cilen mund ta kete shlyer dhe per te cilen ai kerkon portimin, ka edhe llogari te tjera per te cilat eshte debitor. Ne kete rast abonenti nuk duhet lejuar te beje portimin pa shlyer te gjitha borxhet e te gjitha kontratave qe ka me operatoret)

Eshte shume e rendesishme percaktimi se kush nga abonentet do te klasifikohet “bad debt”. Sipas sjelljes se se abonenteve per pagesat, duket qe abonentet nuk i zbatojne me rigorozitet pagesat e faturave te tyre sipas detyrimeve kontraktuale, deri ne daten 23 te leshimit te fatures. Pagesa normale e tyre eshte afersisht tek 60 dite mesatarisht. Keshtu gjenerohet nje risk qe te gjithë abonentet do te klasifikohen si debidore te keqinj, asnje nga operatoret nuk do te leshojne te marrin abonentë e cila con ne nje bllokim te procesit te portabilitetit. Nuk jemi ne favor te ketij kushti.

d. Per klientet postpaid te cilet jane brenda periudhes kontraktuale, ata duhet te informojne operatorin dhenes per terminimin e kontrates perpara procesit te port out ose procesi port out do te lejohet nese ata paguajne vlerat dhe obligimet e tjera nga termat e pergjigjshem te terminimit te kontrates (pika 16.2 e kontrates se abonentit).

Sic e permendem edhe me siper eshte shume e nevojshme te kemi nje percaktim te qarte te detyrimeve ose "bad debt" . te cilat duhet te perfshijne detyrimet aktuale te fatures , detyrimet (fee) mujore te mbetura te kontrates aktuale ne fuqi dhe cdo detyrime tjeter specifik, subvencionime ose zbritje (discounte) te ofruara nga operatori ne keta kontrata.

e. Koha e aprovimit te port out te mos jete me 5 minuta por 48 ore (nevojitet koha e administrimit ose nje oferte me e mire nga operatori aktual nga kendveshtrimi i abonentit)

f. Kancelimi i port out te perfshihet ne rregulat e portimit nese nje kerkese zyrtare nga klienti iniciohet. Koha per kete te percaktohet ne rregullore.

Edhe pse propozohet nga ana e AKEP qe abonenti nuk do te lejohet te portohet pa shlyer te gjitha detyrimet, **nuk eshte se percaktohet procedura qe do te ndiqet midis operatoreve.**

Operatori D ka propozuar dhe propozon serish

2. Krijimin e nje baze qendrore te dhenash te gjitha pajtimtareve per te cilet sipermarresit kane kufizuar aksesin dhe kane nderprere lidhjen e pajtimtarit per shkak te mos permbushjes se kushteve te kontrates apo mos shlyerjes se pagesave sipas kushteve te percaktuara ne kontrate.

a. Ne kete database operatoret te kene akses dhe te ndajne informacionin ne lidhje vlerat e borxhit ne nje ose disa rrjeta njekohesisht, kohen minimale te qendrimit ne rrjetat perkates duke percaktuar qarte shkaqet pse klienti eshte futur ne kete database, nese eshte per borxhi te keq, apo suate Fraudi.

b. Sipermarresit te refuzojne kerkesen e nje pajtimtari te dhenat e te cilit gjenden ne regjistrin e krijuar per port out deri ne momentin kur vertetohet se ky pajtimtar ka permbushur kushtet e kontrates dhe ka shlyer plotesisht pagesat kundrejt operatorit per sherbimin e ofruar.

c. Administrimi i kesaj regjistri te te dhenave mund te kryhet nga subjekte te autorizuar nga AKEP. Kushtet per menyren dhe formen e deklarimit te te dhenave nga ana e sipermarresve si dhe menyra e mbullimit te shpenzimeve per mbajtjen e ketij regjistri percaktohen me vendim te AKEP.

d. Te pergatitet nje rregullore perkatese per administrimin e bazes se te dhenave duke e kaluar me pare ne procesin e konsultimit public me operatoret e interesuar per marrjen parasysh te kerkesave dhe sugjerimeve te biznesit perkates.

e. I gjithë ky proces mund te realizohet me vendim te keshillit drejtues te AKEP i cili mund te autorizojë krijimin e nje baze te te dhenave. Si analogji dhe eksperience mund te permendimm sistemin bankar ne Shqiperi i cili ka realizuar nje database te tille.

Kujdes i vecante i duhet dhene transparences dhe eliminimit te perpjekjeve abuzive per te penguar port-out e pajtimtareve per shkak te borxheve te keqija, ndersa pajtimtari nuk ka me detyrime te till ate konsiderueshme. Si do te menaxhohet nje suate e tille?



Si parakusht themelor per te pranuar konceptin e “bad debt” si nje arsye refuzimi eshte transparencia. Ne gjykojme se mungesa e ketij sistemi nuk do te ndihmoje ne arrijten e qellimeve te procesit te portabilitetit.

Nje tjetër problem qe del dhe nuk eshte adresuar nga ky amendim jane ndryshimet qe ky propozim do te sjelle tek proceset teknike, te cilat nuk jane te qarta dhe gjithashtu mund te kerkojne amendime te specifikimeve teknike, si psh. koha e konsiderueshme per implementim. Nuk eshte i qarte procesi qe do te jete ne kete rast, sa kohe do pritet, ku do te pritet per procesin. Ndryshimet e ketyre neneve ne Rregulloret per Portabilitetin e Numrit kane nevojë per kohe per fizibilitetin dhe implementimin ne sisteme. Nuk ka asnje sqarim se si do te funksionje.

**Si konkluzion problemet kryesore qe gjenerohen nga keto ndryshime jane: Transparencia e veprimeve, procedura qe do te ndiqet per futjen e kesaj hallke si dhe implementimi teknik per te cilat lindin ceshtjet si me poshte:**

- Ceshtja qe duhet trajtuar me kujdes eshte transparencia dhe elimini i situatave abuzuese te ndalimit te portimit te abonenteve per shkakun e “bed debts”, nderkohe qe abonenti nuk eshte me borxhe. Si do te manaxhohet nje suate e tille?
- Ndryshimi ne rregullore per moslejimin e portimit te abonentit deri ne shlyerjen e borxheve, pa nje procedure te qarte dhe transparente midis operatoreve, vetem sa do te rendonte maredheniet midis operatoreve pa zgjidhur problemin qe pretendojme te zgjidhim.
- Problem tjetër qe del nga ky ndryshim dhe qe ketu nuk del se si duhet te operohet eshte ndryshimet qe kjo do te sjelle ne proceset teknike, te cilat nuk jane te qarta dhe qe do te kerkojne ndoshta edhe ndryshimet ne specifikimet teknike si dhe kohen perkatese te implementimit.
- Nuk eshte i qarte procesi qe do te zhvillohet ne kete rast, sa kohe do te pritet per kontrollin e bed debt, ku do te pritet etj.
- Ndryshimi i ketyre neneve kerkon parashikimin e kohes per implementimin ne sisteme. Nuk ka asnje shpjegim se si ky process do te funksionoje nga ana teknike

**AKEP ka propozuar** se duhet vendosur një **kohë minimale e detyrueshme** për kërkuesin e bartjes që të qëndrojë për të paktën 3 muaj në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje. Kështu në Kapitullin II, Të drejtat dhe detyrimet në kontekst të portabilitetit të numrit, Neni 4, pika 5, Të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit, te Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar:

*“Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit dhënës mund të parashikojë që pajtimtari duhet të paguajë kompensim për përfitime të caktuara nga kontrata, siç janë uljet ose telefonat e subvencionuar, nëse pajtimtari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të kontratës. Kohëzgjatja minimale e kontratës dhe shuma e kompensimit duhet të përcaktohet në kontratë.”*

Të ndryshojë dhe të bëhet:

*“Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit dhënës mund të parashikojë që pajtimtari duhet të paguajë kompensim për përfitime të caktuara nga kontrata, siç janë uljet ose telefonat e subvencionuar, nëse pajtimtari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të kontratës. Kohëzgjatja minimale e kontratës dhe shuma e kompensimit duhet të përcaktohet në kontratë. Koha minimale e detyrueshme për kërkuesin e bartjes që të qëndrojë në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje është 3 muaj.”*

## **Komentet e operatoreve:**

**A:**

Per sa i perket propozimit te AKEP mbi kohen minimale qe pajtimtari duhet te qendroje me operatorin, rrendojrme se afati 6 mujor eshte me i pershtatshem per permbushjen e synimit te AKEP per reduktimin e mosmarreveshjeve midis operatoreve. Gjithashtu , ky afat do te zgjidhte edhe problemin e paqendrueshmerise se pajtimtareve te cilet "kercejne" te joshur edhe nga ofertat e operatoreve, nga nje operator ne tjetrin duke shkaktuar mosmarreveshje dhe konkurrence te pandershme.

## **Operatori B:**

Operatori B gjykon se nuk duhet aplikuar një kohë minimale e detyrueshme për kërkuesin e bartjes që të qëndrojë në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje.

Proçesi i portabilitetit është në rradhë të parë një proçes në favor të pajtimtarit dhe për rritjen e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike. Përfshirja e çdo periudhe kycje (lock-in) të pajtimtarit përbën një rrezik për funksionimin e mirë të proçesit të portabilitetit. Operatori B gjykon se pajtimtarët duhet të lejohen të portojnë numrat e tyre në çdo moment dhe Rregullorja parashikon tashmë që operatorit dhënës mund të kërkojë nga pajtimtari kompensimin e përfitimeve të përcaktuara në kontratë (si p.sh. uljet), në rast se pajtimtari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të saj.

## **Operatori C:**

Vendosja e kohes minimale te detyrueshme per kerkuesin e bartjes per te qendruar te pakten 3 muaj ne operatorin ne te cilin eshte bartur, perpara se te vendose nje kerkese tjetere per bartje. Operatori C, sic edhe eshte shprehur ne korrespondenca te meparshme ne lidhje me procesin e portabilitetit te numrit. mbeshtet ne parim propozimin e AKEP, por kerkon ndryshimin e afatit nga 3 mujor ne 6 mujor.

Operatori C gjykon se qendrimi i detyruar 6 mujor i pajtimtarit ne nje rrjet, eshte i domosdoshem per ti subvencionuar operatorit dhenes, kostot financiare shtese, te lidhura me alokimin e numrit, dhenien e benefiteve apo perfitimeve te tjera pajtimtarit, detyrimet e prapambetura, shtimin e rasteve gjyqesore, kostove operacionale te operatorit etj. Vendosja e ketij afati te detyrueshern do te sherbente ne zgjidhje te problemeve te lindura per shkak te detyrimeve te pashlyera, duke mos demtuar nga ana tjetere procesin, pasi ky eshte nje fakt lehtesisht i verifikueshern nga operatoret dhe pajtimtari, dhe nuk perben shkak per abuzim me procesin.

Gjithashtu kerkojme qe ky ndryshim te reflektohet ne Nenin 15 pika C te Rregullores se Portabilitetit te Numrit, duke shtuar nje arsye te gjashte refuzimi :

*"ff) Numri cili do te bartet eshte portuar 6 muajt e fundit ne rrjetin e operatorit dhenes "*,

### **Komente te tjera:**

Operatori C kerkon *perfshirjen ne Rregulloren e Portabilitetit te Numrit te rregullave mbi portimin e institucioneve dhe pergjegjesine imlividuale te pagesave*, te cilat jane derguar tek operatoret me shkresen e AKEP Nr.287 Prot. date 05.02 .20 13 *"Per zbatimin e drejte te rregullave lidhur me kerkesat per portimin e numrave "*.

Konkretisht ne Rregullore duhet te percaktohet qarte sisht se:

*"Rregullorja trajton vetem bartjen e numrave nen efektet e nje kontrate individuale. Perfaqesuesit ligjore te institucioneve, kane te drejte te kryejne kerkese per bartje ne grup vetem per numrat te cilet ndodhen nen efektet e nje kontrate, shpenzimet telefonike te te cileve perballohen nga buxhet i shtetit, por edhe ne kete rast formulari i regjistrimit te perdoruesit duhet te jete individual "*.

### **Operatori D**

Operatori D nuk eshte dakort me propozimin e AKEP per sa i perket kohes minimale te detyrueshme prej **3 muajsh** per kerkuesin e bartjes per te qendruar tek operatori ku eshte bartuar deri ne kerkesen tjetere per bartje.

Koha minimale e detyrueshme per kerkuesin e bartjes per te qendruar tek operatori ne te cilin eshte bartur **duhet te jete 6 muaj** deri ne kerkesen tjetere per bartje, pasi Operatori D gjykon qe afati prej 3 muajsh per qendrimin e abonentit eshte i shkurter dhe i pamjaftueshem ne raportet dhe marredheniet kontraktuale qe lindin midis tyre dhe kostot e shkaktuar ne rrjet.

Per me teper marredheniet kontraktuale midis operatoreve dhe abonenteve jane 1 vjecare ose dy vjecare. Afati 3 mujor i propozuar nga AKEP eshte mjaft i shkurter sidomos per kontratat 2 vjecare, per arsyet qe thame me siper.

Keshtu Operatori D propozon qe afati i qendrimit te abonentit ne nje operator te jete 6 muaj.

Per sa me siper kjo do te reduktojte kostot administrative dhe kostot per marrjen e klienteve te rinj per te gjithë operatoret dhe i jep klienteve maksimumin e benefiteve nga ky proces

**AKEP** ka propozuar qe paragrafi aa) - kërkesa për bartje nuk mund të lexohej ose ka ndonjë gabim tjetër lidhur me specifikimet teknike të kërkesës për bartje; te pikes 2), gërma c) te nenit 15 të Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, "Për Portabilitetin e Numrit", miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar, të hiqet dhe të ndryshojë gërmëzimi i paragrafit, bb) të bëhet aa) e kështu me rradhë. Me këtë ndryshim përmbajtja e paragrafit:

*Operatori dhënë nuk do të dërgojë përgjigje negative për asnjë arsye tjetër përveç këtyre gjashtë arsyeve të përmendura më sipër.*

bëhet:

*Operatori dhënës nuk do të dërgojë përgjigje negative për asnjë arsye tjetër përveç këtyre pesë arsyeve të përmendura më sipër.*

## **Komentet e operatoreve:**

**A:**

Mbi propozimi n e AKEP per te hequr ne nenin 15, Pergjigja per bartje , pike 2), germa c) paragraf i aa): "kerkesa per bartje nuk mund te lexohej ose ka ndonje gabim tjetër lidhur me specifikimet teknike te kerkeses per bartje", jemi dakort me propozimin e AKEP.

**B:**

Operatori B është dakort me propozimin e AKEP që kjo arsye e refuzimit të kërkesës për bartje të shfuqizohet, pasi është subjektive dhe keqpërdoret nga Operatorët dhënës për të refuzuar kërkesat për bartje dhe vonuar procesin, pa specifikuar arsyen konkrete të refuzimit të kërkesës për bartje.

Operatori B gjykon që Operatori dhënës të mund të refuzojë Kërkesën për bartje për të gjitha arsyet e parashikuara në nenin 15, pika 2. c të Rregullores së Portabilitetit përfshirë ato të propozuara më sipër nga Operatori B.

Komente te tjera:

- Të hiqet afati kohor prej 8 orësh për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e komunikimeve midis operatorëve jashtë mesazheve të CRDB

Duke marrë shkas nga problemet aktuale me të cilat përballen operatorët gjatë procesit të portabilitetit, në lidhje me refuzimin e kërkesave për bartje nga operatori dhënës pa asnjë justifikim, afati kohor prej 8 orësh i parashikuar në Nenin 17 të Rregullores, për bashkëpunimin midis operatorëve për të gjetur një zgjidhje, u jep DO një justifikim shtesë për vonesën e procesit. Sikurse ky problem është adresuar tashmë në AKEP shumë herë, ka patur raste që pas një dite DO ka sugjeruar që kërkesa të përsëritet me të njëjtat të dhëna që ishin refuzuar herën e parë. DO nuk japin sqarime për këto sjellje, por rezultati është shqetësimi i pajtimtarëve që shpesh pasohet nga kërkesa për anulimin e procesit të bartjes nga vetë pajtimtari, kosto dhe kohë të shpenzuara nga RO dhe dëmtim i reputacionit të RO.

Sa më sipër, sugjerojmë se afati kohor i parashikuar në Nenin 17 dhe çdo komunikim midis operatorëve veç mesazheve të shkëmbyera nëpërmjet CRDB duhet të hiqen. Në rast refuzimi të pajustificuar të kërkesës për bartje, Operatori marrës duhet të ankohet drejtpërdrejt pranë personit të kontaktit mbi portabilitetin në AKEP, dhe nëse ky i fundit gjen se refuzimi nuk ka qenë i justifikuar në bazë të ligjit dhe Rregullores, do të urdhërojë ekzekutimin e bartjes dhe fillojë procedurat ligjore për marrjen e masave dhe aplikimin e penalteteve të parashikuara në Ligj.

Për më tepër, duke marrë parasysh ndalimin që u krijohet pajtimtareve për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore, në rast vonese të pajustificuar të procesit të portabilitetit nga operatori dhënës, ky i

fundit duhet t'i paguajë një kompensim pajtimtarit për çdo orë vonese, në një shumë të përcaktuar në Rregullore.

Këto dispozita zbatuese dhe aplikimi i tyre nga AKEP janë thelbësore për të ruajtur efikasitetin e procesit të portabilitetit të numrit. Nga ana tjetër Operatori B i kërkon AKEP një rol më aktiv me qëllim përmbylljen e procesit brenda një afati sa më të shkurtër kohor.

Për këto arsye Operatori B kërkon që neni 17 i Rregullores për Portabilitetin të ndryshohet si vijon:

“1. Operatori dhënës dhe marrës do të përpiqen të zgjidhin problemet dhe mosmarrëveshjet në lidhje me procesin e portabilitetit nëpërmjet mesazheve standarte elektronike të përcaktuara në këtë kapitull.

2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarte elektronike, Operatori marrës i drejtohet drejtpërdrejt për ndërhyrje më qëllim zgjidhjen e problemit, personit të kontaktit mbi portabilitetin në AKEP.

3. Mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet këtij procesi do të zgjidhen nëpërmjet mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të nenit 120 te Ligjit 9918/2008.”

- Të hiqet me efekt të menjëhershëm diskriminimi i aplikuar ndërmjet operatorëve celularë për aplikimin e afateve kohore

B konsideron se standardet për automatizimin e plotë të procesit të bartjes duhet të jenë të zbatueshme për të gjithë operatorët celularë njësoj dhe pa dallim. Në kuadër të automatizimit të plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë për rrugëzimin e thirrjeve edhe për operatorët me nën 100.000 pajtimtarë, dhe mbështetur nga evidencat e padiskutueshme statistikore që sot nuk ekziston asnjë operator celular që ka më pak se 100.000 pajtimtarë, Operatori B kërkon që të gjithë operatorët të zbatojnë automatizimin e plotë të procesit të bartjes, që nënkupton integrimin automatik të mesazheve që shkëmbehen me bazën e të dhënave referencë të centralizuar dhe zbatimin e të njëjtit afat kohor prej 5 minutash në mënyrë jo-diskriminuese për përgjigjen ndaj Kërkesës për Bartje (pra kërkimin e automatizuar të bazës së të dhënave së pajtimtarëve për Operatorët).

Rregullorja për Portabilitetin e Numrit nuk duhet të parashikojë asnjë diskriminim lidhur me operatorët me më pak se 100.000 pajtimtarë, aq më tepër kur që prej dy vitesh nuk ka asnjë operator celular që të ketë më pak se 100.000 pajtimtarë. Të gjithë operatorët duhet të aplikojnë në mënyrë të barabartë afatet kohore për dërgimin e përgjigjes së bartjes së numrit dhe për përfundimin e procesit të bartjes.

Për këto arsye dhe në zbatim të dispozitave të ligjit 9918, neni 7 që parashikojnë trajtim të barabartë, jo-diskriminues për të garantuar konkurrencë të ndershme dhe eficiente në treg, Operatori B kërkon që pika 5 e nenit 15 të Rregullores për Portabilitetin të shfuqizohet.

- Sqarimi i procesit për anulimin e mundshëm të portabilitetit të numrit nga pajtimtari

Operatori B është gjetur shpesh herë në pozitë të vështirë para kërkesave të pajtimtarëve, si edhe Operatorëve dhënës (kur pajtimtari ua ka dorëzuar atyre kërkesën) për anulimin e procesit të portabilitetit, pasi pajtimtari ka ndërruar mendje përgjatë procesit. Në përputhje me interpretimin e AKEP, Operatori B ka refuzuar kërkesa të tilla duke theksuar se procesi i portabilitetit të numrit është një proces i pandërprerë, që nuk mund të anulohet. Kështu parimisht, pasi kërkesa për bartje është nënshkruar së bashku me kontratën e pajtimit, pajtimtari nuk mund të tërheqë kërkesën e tij për bartje.

Operatori B sugjeron që interpretimi i AKEP të përcaktohet qartë në Rregulloren për Portabilitetin me qëllim shmangien e dykuptimësive për refuzimin e kërkesës për bartje nga operatori dhënës për zbatimin e strategjive për rifitim të klientit, i cili për pasojë kërkon anulimin e procesit të bartjes.

Në rast se gjykohet e arsyeshme që anulimi të lejohet shprehimisht nga Rregullorja për Portabilitetin, kushtet sipas të cilave do të pranohej anulimi duhet të parashikohen qartë në Rregullore, si për shembull: të përcaktohet momenti deri në të cilin pajtimtari ka ende të drejtën të anulojë procesin, ku duhet ta dorëzojë pajtimtari kërkesën për anulim, e kështu me rradhë. Operatori B propozon që anulimi i procesit të portimit të parashikohet shprehimisht në Rregulloren për Portabilitetin, duke lejuar pajtimtarin që të ketë të drejtë të anulojë procesin e bartjes me një kërkesë drejtuar RO brenda një afati prej 24 orësh nga nënshkrimi i kërkesës për bartje. Pas këtij momenti pajtimtari nuk mund të tërheqë kërkesën e tij për bartje. Për këtë arsye Operatori B propozon që të shtohet pika 7 në nenin 12 të Rregullores për Portabilitetin si vijon:

“7. Proçesi i bartjes mund të anulohet më kërkesën e pajtimtarit që ka kërkuar bartjen, drejtuar Operatorit marrës, brenda 24 orësh nga momenti që është nënshkruar Kërkesa për Bartje. Pas këtij momenti pajtimtari nuk mund të anulojë kërkesën e tij për bartje.”

- Numri limit ditor i kërkesave për bartje në CRDB duhet të përfshijë vetëm kërkesat e pranuar dhe jo ato të refuzuara

Aktualisht, CRDB (në përputhje me manualin e përdorimit) ka një limit ditor prej 600 + 600 numra të pranuar dhe të refuzuara. Operatori B ka hasur shpesh raste me kërkesat për bartje që i arrijnë Operatorit dhënës të nesërmen për shkak të arritjes së numrit ditor limit të kërkesave për bartje që merren nga Operatori dhënës. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi të theksuar te pajtimtarët dhe ka krijuar hapësira dhe potencial për abuzivizëm nga DO.

Operatori B konsideron se ky limit ditor duhet arritur vetëm me llogaritjen e kërkesave, bartja e të cilave është pranuar, ndërsa kërkesat e refuzuara nuk duhen llogaritur për limitin ditor, meqenëse kërkesat e refuzuara nuk afektojnë hapat e procesit në vijim deri në përfundimin e bartjes.

Për sa më sipër, Operatori B kërkon ndryshimin e manualit të CRDB, duke hequr kërkesat për bartje të refuzuara në llogaritjen e limitit ditor, në mënyrë që të ketë një limit ditor prej 1200 numrash, për të cilat bartja është pranuar.

- Fshirja e ndarjes në ndërfaqen elektronike e CRDB ndërmjet numrave me parapagesë dhe numrave me kontratë

Ndarja ndërmjet kategorive të pajtimtarëve, me parapagesë dhe me kontratë ka çuar në problematika lidhur me refuzimin e kërkesës për bartje me arsyen se është dërguar në kategorinë e gabuar, sipas bazës së të dhënave të DO. Sipas Rregullores për Portabilitetin, kjo arsye refuzimi nuk ka asnjë bazë në Nenin 15, pika 2. Për këtë arsye, Operatori B sugjeron që ndarja “Mobile Postpaid” dhe “Mobile Prepaid” duhet hequr e si rrjedhim në ndërfaqen e CRDB të ketë vetëm dy kategori: Fixed dhe Mobile.

- Rritja e kapacitetit maksimal të numrave (MSISDN) për kërkesë

Aktualisht, informacioni për sasinë e numrave që mund të kërkohet bartja me një kërkesë mungon në manualin e CRDB. Megjithatë, sipas eksperiencës tonë, nuk është e mundur të procedohet me bartjen e më shumë se 400 numrave në të njëjtën kërkesë. Aktualisht, sasia maksimale e numrave në një kërkesë për bartje, që është pranuar nga CRDB është 300-350 numra.

Nisur nga praktika e punës e deritanishme, kërkesat e pajtimtarëve, dhe për të thjeshtuar punën e operatorëve por edhe për të shpejtuar procesin, sugjerojmë që kapaciteti i numrave që mund të

dërgohen me një kërkesë për bartje të jetë i barabartë me limitin ditor të CRDB prej 1200 numrash në total.

### **Operatori D**

Operatori D nuk e mbështet teresisht propozimin e AKEP për heqjen e paragrafit (aa) pika 2/germa c e nenit 15 “Pergjigja per bartje”, edhe pasi ky paragraf eshte i paqarte dhe si i tille ka krijuar situata te ndryshme abuzive ne lidhje me pergjigjet negative nga operatori dhenes (kujtojme se disa operatore e kane perdorur me sukses kete shkak refuzimi n portabilitet), duke sherbyer me shume si pretekst per te bllokuar portimin e numrit te abonentit, pasi nuk eshte specifikuar qarte se cilat jane gabimet ne lidhje me specifikimet teknike te kerkeses per bartje, apo se kjo kerkese nuk mund te lexohet qarte, duke sherbyer shpesh si justifikim per nje pergjigje negative.

Menyra se si eshte formuluar ky paragraf le hapesia per interpretime te ndryshme dhe per te abuzuar duke justifikuar ne menyre te padrejte dhenien e nje pergjigje negative nga ana e operatorit dhenes.

Megjithate ne kerkojme qe nese ky paragraf do te qendroje te specifikohet qarte se kush jane rastet, sepse nuk ka situata perfekte te operimit. Gjate procesit te portimit mund te ndodhin refuzime per te tilla shkaqe teknike dhe keto duhet te jene te parashikuara per te mos krijuar probleme te tjera .